



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/163
Datë: 06.10.2023

Në mbështetje të nenit 17, të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafit 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 tetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi për të kërkuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës, dhënien e autorizimit Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve për nënshkrimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Korporata Energetike e Kosovës (KEK) Sh. A. dhe KfW, Frankfurt Am Main, për Projektin "Programi i Energjisë Solare I (Solar 4 Kosovo I) - Fotovoltaike".
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/163
Datë: 06.10.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 15 paragrafit 2. të Ligjit Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-213 dhe Ligjin Nr. 08/L-235, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 tetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për ndarjen shtesë të mjeteve buxhetore në shumë prej 3,000,000.00 € (tre milionë euro), për projektin "Rehabilitimi i Rrugëve Rajonale".
2. Mjetet buxhetore sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me kod 201, nga nën programi "Kontigjencat në Ministrinë e Financave" me kod 28900, nga kategoria e shpenzimeve "Shpenzime kapitale" nga Projekti "Projekti kapital/Kontigjenca në MF" kod 18546, dhe transferohen në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me kod 205, me nën programin "Rehabilitimi i Rrugëve" me kod 41800, në kategorinë e shpenzimeve "Shpenzime kapitale" në Projektin "Rehabilitimi i Rrugëve Rajonale" me kod 15039.
3. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë